

ALARM TATIMOR
NËNTOR 2020

Për t'ju informuar me ndryshimet më të fundit në legjislacionin ligjor dhe financiar, ky alarm tatimor i përgatitur nga "A.R.S Legal & Financial Services" Ltd, ju ofron informata të vlefshme mbi publikimet më të fundit të legjislacionit shqiptar.

Në Fletoren Zyrtare Nr. 190, datë 02.11.2020, është publikuar:

Udhëzimi i Përbashkët nr. 4620, datë 14.10.2020, "Për mënyrën e ekzekutimit të kundravajtjes administrative për mospërdorimin e barrierës mbrojtëse (maskës), nëpërmjet Operatorit Të Sistemit Të Shpërndarjes Së Energjisë Elektrike (OSHEE)".

Ky udhëzim njofton mënyrën sesi do të paguhet kjo gjobë, për të cilën gjeni informacionin si më poshtë vijon:

Institucionet përgjegjëse për vendosjen e gjobës ndaj individëve të cilët nuk vendosin barrierën mbrojtëse (maskën) janë Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake. Për individin e ndaluar nga këto autoritete, mbahet procesverbali i gjobës, i cili përmban të dhënat bazë në lidhje me emrin, mbiemrin, atësinë, nr. e kartës së identifikimit, si dhe adresën e banimit të individit.

Kjo gjobë do i bashkangjitet faturës së energjisë elektrike të muajit respektiv.

Gjoha do të jetë titull ekzekutiv dhe nuk do mund të paguhet pjesërisht ose e shkëputur nga fatura e energjisë elektrike. Pagesa jashtë afatave do të shoqërohet me kamatvonesat përkatëse në përputhje

TAX ALERT
NOVEMBER 2020

To keep you up to date with the latest changes in Albanian legislation, this tax alert prepared by "ARS Legal & Financial Services" Ltd provides you with valuable information on the latest publications of the Albanian legislation.

In the Official Gazzete No.190, dated 02.11.2020, is published:

Joint Instruction no.4620, dated 14.10.2020, "On the manner of execution of the administrative contravention for not using the protective barrier (mask), through the electricity distribution operator (OSHEE)".

This instruction notices the way how the penalty will be paid, for which find the necessary information as follow:

The responsible institutions for imposition of penalties for individuals that do not use protective barriers (mask) are State Police and Municipal Police. For each of individuals prohibited from the authorities, is held a report which contain the basic data regarding the name, surname, fathers name, no. of ID, and residential address.

The penalty will be attached to the electricity bill of the respective month.

The penalty is considered as an executive title, and cannot be paid in part or separately from the electricity bill. Overdue payment will be accompanied by relevant interest in accordance with the electricity contract. Non-payment of the penalty

me kontratën e energjisë elektrike. Mospagesa e gjorbës si pjesë përbërëse e faturës do të klasifikojë individin si debitor ndaj FSHU-së dhe kontrata përkatëse e energjisë elektrike do të dërgohet për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike.

Pagesat mund të bëhen pranë të gjitha zyrave përkatëse të përcaktuara nga FSHU-ja, pranë Postës Shqiptare dhe pranë cdo institucioni financiar ku paguhet fatura e energjisë elektrike.

Vendimi nr. 836, datë 28.10.2020, “Për Përcaktimin e Kritereve të Dokumentacionit e të Procedurës për Pajisjen, Ripërtëritjen, Refuzimin dhe Anullimin e Lejes së Punës për Shërbime Kontraktuese të Tipit “C/SHK”, si dhe të Tarifës Shtetërore për Lëshimin e kësaj Lejeje Pune”.

Kjo leje pune i referohet shtetasve të Huaj, të cilët vijnë në RSH dhe kryejnë Shërbime Kontraktuese.

I huaji pajiset me leje pune të tipit “C/SHK”, për një periudhë për një kohëzgjatje jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një viti kalendarik, nëse ai plotëson disa kritere si:

- *Kryerja e veprimtarisë ose ofrimi i shërbimeve bazuar në një kontratë;*
- *Duhet të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë;*
- *Duhet të kenë të paktën dy vjet eksperiencë në fushën e veçantë, objekt i kontratës së shërbimit;*
- *Ka një kontratë të rregullt pune për shërbime kontraktuese me punëdhënësin etj.*

I Huaji rezervon të drejtën e ripërtëritjes së lejes së punës, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- *Kur lidhet kontrata për më shumë se një vit, leja ripërtërihet në bazë një vjecare;*
- *Kur ka një kontratë të rregullt pune jo më shumë se 90 ditë për vitin në vazhdim;*
- *Kur nuk ka kryer shkelje të legjislacionit të punës në vitin pararendës, etj.*

as an integral part of the invoice will classify the individual as a debtor of FSHU and the respective contract of electricity will be interrupted.

Payments can be made at all relevant offices designated by FSHU, at the Albanian Post office and at any financial institution where the electricity bills can be paid.

Decision NO. 836, dated 28.10.2020 “For Determining the Criteria of Documentation and Procedure for Equipment, Renewal, Cancellation and Refusal of Work Permit for Contracting Services type “C/CS”, and Institution Fee to issue this working permit.

This work permit refers to Foreign nationals who come to the Republic of Albania and perform Contracting Services.

The foreigner is provided with a work permit type “C / CS” for a period not exceeding 90 (ninety) days within a calendar year, if he meets certain criteria such as:

- *Performing the activity or providing services based on a contract;*
- *Must be engaged in providing a service on a temporary basis in the Republic of Albania;*
- *Must have at least two years of experience in the specific field, object of the service contract;*
- *Has a regular employment contract for contracting services with the employer etc.*

The foreigner reserves the right to renew the work permit, if he meets the following criteria:

- *When the contract is concluded for more than one year, the permit is renewed on a one-year basis;*
- *When there is a regular employment contract not more than 90 days for the following year;*

Aplikimi realizohet nga subjekti ose përfaqësuesi i tij, nëpërmjet shërbimit elektronik të portalit e-albania dhe më pas me depozitim të dokumentacionit përkatës pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Për ripërtëritjen e lejes së punës, kërkesa duhet paraqitur brenda 30 ditëve para përfundimit të lejes paraardhëse.

Kostot për aplikimin për herë të parë me leje pune të tipit “C/SHK”, është 4000 lekësh, ndërsa për rinovimin e lejes është 2000 lekësh.

Nëse të huajt i refuzohet leja e punës ka të drejtën e ankimit.

Në Fletoren Zyrtare Nr. 197, datë 12.11.2020, janë publikuar disa ndryshime në kuadrin ligjor të tatim-taksave, konkretisht:

- **Ndryshimi në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”.**

Paragrafi i parë i Nenit 10 të ligjit “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël”, parashikonte detyrimin e pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, ndërsa ndryshimi i fundit përcakton se cdo biznes bëhet subjekt i të gjitha detyrimeve të parashikuara në kreun 3 të ligjit.

Neni 11, për Shkallën Tatimore, parashikonte tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël me qarkullim vjetor nga 2-8 milionë lekë në 7.5%, dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0-2 milionë lekë, është 26000 lekë në vit, ndërsa tani është parashikuar për të gjitha bizneset e vogla me qarkullim vjetor nga 0-8 milion lekë, shuma është 0 lekë.

Neni 16, për Deklarimin, parashikonte që tatimpaguesit me qarkullim nga 2-8 milionë lekë, janë të detyruar deri me datën 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojnë një deklaratë vjetore tatimore ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për tu paguar, dhe cdo hollësi tjetër e kërkuar nga

- When he has not committed a violation of labor legislation in the previous year, etc.

The application is realized by the subject or its representative, through e-Albania portal and then by submitting the relevant documentation to the National Employment and Skills Agency (KPA). To renew the work permit, the application must be submitted **within 30 days before the expiration of the previous permit.**

The costs for the application for the first time with a work permit type “C / CS”, is 4000 ALL, while for the renewal of the permit is 2000 ALL.

If the foreigner’s permit is denied he has the right to appeal.

In the Official Gazette no. 197, dated 12.11.2020, some changes in the tax legal framework have been published, concretely:

- **Amendment to law no. 9632, dated 30.10.2006, “ON THE LOCAL TAX SYSTEM”.**

The first paragraph of Article 10 of the law “On simplified profit tax for small business”, provided the obligation to pay simplified profit tax for small business, while the last amendment stipulates that every business becomes subject to all obligations provided in Chapter 3 of the law.

Article 11, for the Tax Rate, provided for the simplified profit tax for small business with an annual turnover from 2-8 million ALL to 7.5%, and for entities with an annual turnover from 0-2 million ALL, is 26000 ALL per year, while now it is foreseen for all small businesses with annual turnover from 0-8 million ALL, the amount is 0 ALL.

Article 16, for the Declaration, provided that taxpayers with a turnover of 2-8 million ALL, are obliged until February 10 of the year following the tax period, to submit an annual tax return detailing the total income, expenses and expenses. deductible, taxable profit, tax payable, and any other details required by the Ministry of Finance, while now this

Ministria e Financave, ndërsa tani kjo parashikohet për të gjithë tatimpaguesit që janë subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Neni 17, për Administrimin e Tatimit, parashikonte që, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, ndërsa pas ndryshimeve parashikohet që institucionet e mësipërme ngarkohen vetëm me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Ky ndryshim hyn në fuqi më 1 Janar 2021.

- **Shtesë në ligjin nr. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.**

Në nenin 49 të ligjit, “Për Shkallët e Reduktuara”, është shtuar pika 9 e cila shprehet për shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, që aplikohet për furnizimin e shërbimeve të punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive, apo federatave sportive, të përcaktuara në legjislacionin e fushës për sportin, që është në nivelin 6%.

Ky ligj hyn në fuqi më 21 Janar 2021.

- **Ndryshimi në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.**

Si datë e mospagimit në mënyrë vullnetare të detyrimeve tatimore, do të merret dita e parë e punës mbas datës së vendosur në njoftimin nga administrata tatimore. Në rast se në atë datë tatimpaguesi nuk e ka kryer pagesën e detyruar tatimore, titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore nxjerr urdhërblokimin e llogarive bankare, si masë për garantimin e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor.

Në urdhër përfshihet identiteti i plotë i tatimpaguesit, llogaritë që preken nga dalja e këtij urdhëri, shkaku i nxjerrjes së tij, llojin e detyrimit që po ekzekutohet, datën kur tatimpaguesi duhet ta kishte paguar vetë

is provided for all taxpayers who are subject to simplified small business profit tax.

Article 17, on Tax Administration, provided that the General Directorate of Taxes, through the Regional Tax Directorates, is in charge of assessing, collecting, controlling, collecting and transferring to the local government budget account the revenues from the simplified profit tax. small business, while after the changes it is foreseen that the above institutions are charged only with the assessment and control of taxpayers, subject to the simplified tax on the profit of small business.

This amendment shall enter into force on 1 January 2021.

- **Addition to law no. 92/2014, “ON VALUE ADDED TAX IN THE REPUBLIC OF ALBANIA”.**

In Article 49 of the law, “On Reduced Scales”, point 9 has been added, which states the reduced rate of value added tax, which is applied for the provision of construction works services for state investments of sports clubs or federations sports, defined in the legislation of the field for sports, which is at the level of 6%.

This amendment shall enter into force on January 21, 2021.

- **Change in instruction no. 24, dated 02.09.2008, “ON TAX PROCEDURES IN THE REPUBLIC OF ALBANIA”.**

As the date of voluntary non-payment of tax liabilities, the first working day after the date set in the notification by the tax administration will be taken. If on that date the taxpayer has not made the obligatory tax payment, the head of the tax office of the local government issues an order to block the bank accounts, as a measure to guarantee the forced collection of the tax liability.

The order includes the full identity of the taxpayer, the accounts affected by the issuance of this order, the reason for its issuance, the type of obligation being executed, the date when the taxpayer should

<p>detyrimin tatimor si dhe shuma që bankat duhet të bllokojnë.</p> <p>Në rast se detyrimi i tatimpaguesit ekzekutohet plotësisht, administrata tatimore dërgon menjëherë një urdhër zhbllokimi në adresë të bankave ku tatimpaguesi është klient. Në rast se detyrimi i tatimpaguesit ekzekutohet pjesërisht, administrata tatimore dërgon një urdhër të ri bllokimi drejtuar bankave, ku tatimpaguesi ka llogari bankare për shumën e detyrimit tatimor të papaguar që rezulton mbas kryerjes së ekzekutimit të pjesshëm. Në rast se tatimpaguesi nuk ka gjendje në llogaritë bankare në asnjë nga bankat, llogaritë do të vazhdojnë të mbahen të bllokuara në bazë të urdhërbllokimit, që është lëshuar nga administrata tatimore</p> <p>Nëse pas zbatimit ndaj subjektit të të gjitha masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimit, detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, administrata tatimore e transferon detyrimin tatimor të mbetur të subjektit tek ortaku, aksionari dhe administratori.</p> <p>Urdhëri i bllokimit është i vlefshëm për një afat 12 mujor, me kalimin e këtij afati llogaritë dhe depozitat zhbllokohen automatikisht nga banka, pa nevojën e një njoftimi shtesë.</p> <p>Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.</p> <p>Nëse dëshironi të dini më shumë për ndryshimet në legjislacionin shqiptar, na kontaktoni si më poshtë:</p> <p>Email: info@arsfirm.al Telefon: +355 69 247 6387 Web: www.arsfirm.al Adresa e zyrës Rruga "Kavaja" Qendra " Sun Tower ", Kati 6^{të}, Ap. nr. 31, Tiranë, Shqipëri</p> <p>©A.R.S Legal & Financial Service</p>	<p>have paid the tax liability and the amount that banks should block.</p> <p>In case the taxpayer’s obligation is fully executed, the tax administration immediately sends an unlock order to the address of the banks where the taxpayer is a customer. In case the taxpayer’s obligation is partially executed, the tax administration sends a new blocking order to the banks, where the taxpayer has a bank account for the amount of unpaid tax liability that results after the partial execution. In case the taxpayer does not have balance in the bank accounts in any of the banks, the accounts will continue to be blocked based on the blocking order issued by the tax administration.</p> <p>If after the application to the entity of all coercive measures for the collection of the obligation, the tax liabilities of the legal entity are not fully repaid, the tax administration transfers the remaining tax liability of the entity to the partner, shareholder and administrator.</p> <p>The blocking order is valid for a period of 12 months, after which the accounts and deposits are automatically unlocked by the bank, without the need for an additional notice.</p> <p>This instruction enters into force upon publication in the Official Gazette.</p> <p>If you wish to know more on the Albanian legislation, contact us as follows:</p> <p>Email: info@arsfirm.al Phone: +355 69 247 6387 Web: www.arsfirm.al Office Address “Kavaja” Street, “Sun Tower” Center 6th Floor, Apt no. 31, Tirana, Albania</p> <p>©A.R.S Legal & Financial Service</p>
--	---